



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-1864/22
Kaçanik, 28.01.2022

Në bazë nenit 13.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 – për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28 janar 2022, mori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA, PËR VITIN 2021

1. Me këtë Vendim, aprovohet raporti 01Nr. 60/01-1864/22 me tekstin e mëtejshëm "Raporti i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2021" i hartuar nga Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.
2. Në Raportin e Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, është paraqitur aktiviteti i zhvilluar i këtij komiteti përmes mbledhjeve të rregullta dhe aktiviteti tjetër, me qëllim të arritjes së përmirësimit të gjendjes së personave me aftësi të kufizuara në komunën e Kaçanikut.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është, Raporti i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, i përmbledhur në gjithsej 9 faqe.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:, Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, Kryetari i Komunës, dhe Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

Data	15.01.22	Vendi	Kaçanik
Nj. org.		Numri	60/07-1564
		Shtojcë	1

Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipal Kaçanik

Raport i Punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara për vitin 2021

Kaçanik, 2022

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Lista e Shkurtesave.....	3
Fjala e Kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara.....	4
Përmbledhja ekzekutive	5
Korniza Ligjore.....	6
I. Mbledhjet.....	7
II. Takimet	7
III. Hartimi i Planit të Punës 2021	8
IV. Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2021.....	8
V. Kërkesat	9
VI Pjesëmarrja në punëtori të ndryshme.....	9
VII. Aktivitete avokuese.....	9

Lista e Shkurtesave

PAK –Personat me Aftësi të Kufizuara

PLVPAK- Plani Lokal i Veprimit Për Personat me Aftësi të Kufizuara

KKPAK- Komiteti Konsultativ Për Persona me Aftësi të Kufizuara

KKZ- Komisioni Komunal i Zgjedhjeve-Kaçanik

FJALA E KRYESUESIT TË KKPAK-së

I nderuari, Kryesues i Kuvendit Komunal të Kaçanikut, Z. Kemajl Murseli,

Të nderuar anëtar,

Në kuadër të obligimeve të legjislacionit në fuqi, në raport me KKPAK-në përkatësisht Udhëzimit Administrativ(MAPL)Nr01.2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, ne si Komitet paraqesim raportin e punës përgjatë vitit kalendarik 2021. Si Komitet që përfaqëson interesat e komunitetit të PAK-ve në Komunën e Kaçanikut, dhe me një periudhë të shkurtër të punës, jemi munduar që punën tonë ta fokusojmë në avancimin e çështjes së aftësisë së kufizuar duke u munduar që atë ta ngrisim në nivele të prioriteteve në dy drejtime; në atë institucional dhe atë shoqëror Mirëpo, një pengesë drejtë kësaj përpjekje padyshim ka qenë edhe pandemia Covid -19 që ka ndikuar në punën e KKPAK-së, angazhimet profesionale e institucionale të disa anëtarëve të KKPAK-së si dhe trajtesa jo në nivel të duhur nga ana e autoriteteve komunale në raport me KKPAK-në,

Të nderuar anëtar,

Komuniteti i PAK-ve është një nga komunitetet shoqërore më të marginalizuara si nga sfidat personale të tyre por po ashtu edhe nga pamundësia dhe pengesat sociale e institucionale në raport me ta. Kjo veçse është vështirësuar në këto dy vitet e fundit edhe me sfidën e pandemisë COVID-19. Kjo na bën të konstatojmë se problemet dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara në komunën tonë janë të mëdha. Mirëpo, ne si komitet kemi shpresë dhe bindje se një qasje më pro-aktive një koordinim më i mirë institucional dhe një vullnet i përgjithshëm më i madh është garanci në arritjen e qëllimit tonë të përbashkët: përmirësimin e çështjes së aftësisë së kufizuar në komunën tonë. Meqenëse viti 2022 nga Qeveria e Republikës së Kosovës është shpallur si vit i Personave me Aftësi të Kufizuara besojmë që edhe Komuna e Kaçanikut do e trajton çështjen e aftësisë së kufizuar në nivele të tilla të prioriteteve.

Me respekt, Artan Mezraja

Kryesues i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet punën dhe aktivitetet e ndërmarra nga ana e Komitetit për gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2021. Komiteti ka zhvilluar një numër takimesh ad hoc për të përcaktuar agjendën e punës së komitetit përgjatë vitit 2021 e në të cilat takime edhe është e fokusuar më së shumti edhe vetë puna e komitetit në përgjithësi. Megjithatë që në fillim duhet pranuar që Pandemia Covid-19 ka ndikuar edhe në punën dhe aktivitetet e KKPAK-së duke pamundësuar realizimin e disa aktivitete të planit të punës për vitin 2021.

Komiteti ka mbajtur vetëm një (1) mbledhje të rregullt në të cilën janë shqyrtuar çështje të ndryshme. Gjithashtu një pjesë e aktiviteteve ka qenë e rezervuar në monitorimin e Planit të Veprimit të Personave me Aftësi të Kufizuara 2019-2021 të miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut. Brenda këtij raporti janë pasqyruar edhe aktivitetet që Komiteti ka bërë jashtë institucioneve me qëllim avancimin e çështjes së aftësisë së kufizuar.

Korniza Ligjore

Komitetet Konsultative janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, roli i të cilave është që përmes këtyre komiteteve të garantohet që organet e komunave të jenë më transparente, më efikase dhe të japin më shumë llogari qytetarëve. Si të tilla ato mund të angazhohen në : dhënie e propozimeve për rregullore të ndryshme; hulumtime të ndryshme; japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga kryetari i komunës, komitetet e përhershme apo kuvendi i komunës në fushën përkatëse; paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te kryetari i komunës dhe kuvendi i komunës; japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Baza e funksionimit të këtyre komiteteve mbështetet në këto dokumente ligjore: Ligjin Nr. 03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në Udhëzimin Administrativ(MAPL)Nr01.2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna

Përbërja:

Artan Mezraja Kryesues
Mirlinda Axhami Zv- Kryesuese
Argjenta Axhami Anëtarë
Antigona Axhami Anëtarë
Edita Shehu Anëtarë
Fiknete Krasniqi Anëtarë

Mbledhjet

Në bazë të Udhëzimit Administrativ(MAPL)Nr01.2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna janë të përcaktuara në bazë të “nevojave por së paku duhet të mbahen gjashtë(6)takime në vit”. Megjithatë KKPAK ka mbajtur vetëm një mbledhje gjatë këtij viti duke mos përmbushur kuotën normative prej 6 mbledhjeve Brenda vitit. Kjo mungesë e mbajtjes së mbledhjeve ka ardhur si rezultat i dy faktorëve: viti 2021 ka qenë vit elektorale në Kosovë dhe kjo ka ndikuar tek disa anëtar të Komitetit që të jenë pjesë aktive e menaxhimit të këtyre zgjedhjeve(kryesuesi i KKPAK-së z. Artan Mezraja por edhe një anëtar i KKPAK-së ka qenë pjesë e kandidaturës në zgjedhjet lokale(zëvendës kryesuesja Mirlinda Axhami Hysa), prandaj pezullimi i aktiviteteve për të mos u keqkuptuar politikisht ka ndikuar edhe në faktorin e dytë që një pjesë e anëtarëve nuk kanë mbajtur mbledhje vetëm për statistika dhe evidencë mëditjesh.

Në mbledhjen e parë të vitit 2021 e cila është mbajtur me datën 30.04.2021 ku janë diskutuar çështje të ndryshme siç janë:

1. Shqyrtimi i disa kërkesave nga OJQ-të;
3. Informatë rreth takimit me Handikos- Kaçanik;
4. Planifikimi dhe organizimi i një tryeze për PAK ; dhe
5. Të ndryshme.

Brenda kësaj mbledhje janë diskutuar edhe çështje të tjera.

Takimet

Fokusi i punës së KKPAK-së më së shumti është i koncentruar në takime të ndryshme si nga vetë anëtarët e komitetit po ashtu edhe ndërmjet institucioneve, organizatave apo individëve të ndryshëm. Vlen të theksohen takimet e ndryshme që kemi pasur me Kryetarin e Komunës Z. Besim Ilazi në të cilën takime janë adresuar dhe diskutuar tema të ndryshme që nga përmirësimi i legjislacionit (taksat komunale) e deri tek adresimi i kërkesave të organizatave Empoëer edhe Handikos. Në këto takime është kërkuar nga Kryetari dhe nënkryetari që të behët më shumë rreth punësimit të personave me aftësi të kufizuar, duke e vënë në informim kryetarin mbi kuotën e

punësimi të PAK-ve në institucionet komunale dhe mos plotësimin e saj nga institucionet komunale.

Një takim është mbajtur edhe me Handikosin i thirrur po nga ata ku janë trajtuar sfidat e implementimit të legjislacionit për PAK-të.

Një takim është mbajtur edhe me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në Kaçanik ku temë diskutimi ka qenë Përfshirja e PAK-ve në trupat menaxhuese të zgjedhjeve, ku si rezultat i këtij takimi është arritur që në zgjedhjet lokale si anëtarë të këshillave të Vendvotimit të punësohen gjashtë(6) persona me aftësi të kufizuara, duke plotësuar kështu edhe kuotën ligjore nga ana e KKZ-së që çdo i 50 person i punësuar të jetë nga PAK-të.

Po ashtu me datën 2 dhjetor është mbajtur një takim online me anëtarët e komiteteve të PAK-ve të disa komunave ku janë diskutuar sfidat e KKPAK-ve dhe mundësitë e bashkëpunimit në të ardhëm për krijimin e agjendave të përbashkëta avokuese.

Hartimi i Planit të Punës për vitin 2022

Brenda kësaj periudhe janë zhvilluar disa takime për të hartuar planin e punës për vitin 2022, i cili plan është duke u hartuar dhe miratohet në mbledhjen e radhës.

Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2021

Një nga aktivitetet ku është konsumuar kohë në punën e Komitetit ka qenë edhe Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2021. Ky monitorim është bërë duke përdorur dy lloje metodash , atë të vrojtimit të drejtpërdrejtë si dhe metodën e intervistimit të shumë bartësve të institucioneve lidhur me të gjitha objektivat e parapara në këtë dokument. Nga ky monitorim vërejmë se ky PLVPAK nuk është zbatuar në shumësi, pavarësisht disa plotësimeve të tij. Mirëpo, marrë parasysh që ky plan ka qenë i paraparë për tre vite dhe si dokument nuk është valid mbetet shqetësuese për të ardhmen që komuna jonë nuk ka një dokument strategjik për çështjen e aftësisë së kufizuar.

Kërkesat

Si pjesë e punës sonë ka qenë edhe dëgjimi i kërkesave të personave me aftësi të kufizuara dhe adresimi i tyre tek autoritetet komunale. Një nga këto kërkesa në formën verbale ka qenë nga organizata Handikos që si komitet t'i ndihmojmë në promovimin por edhe ndikimin tek autoritetet komunale për përkrahje institucionale rreth start up-it të tyre në prodhimin e sapunëve të lëngshëm.

Pjesëmarrja në punëtori të ndryshme

Një pjesë e anëtarëve të komitetit kanë qenë për dy ditë pjesë aktive e punëtorisë për Hartimin e Strategjisë së Punës për organizatën Handikos në Kaçanik.

Aktivitete avokuese

Me datën 2 dhe 3 dhjetor në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Persona me Aftësi të Kufizuara janë mbajtur ligjërata sensibilizuese me nxënës në 4 shkolla fillore në komunën e Kaçanikut për integrimin e PAK-ve në jetën sociale e publike. Gjithashtu në këtë datë është mbajtur edhe një takim me nënkryetarin e komunës Z. Ylber Bajra ku është kërkuar që si institucione të bëjnë më shumë për PAK-të dhe që viti 2022 të jetë po ashtu vit prioritar edhe për komunën e Kaçanikut për PAK-të.

Kryesuesi i KKPAK
Artan Mezraja

